

Shkodër, më ____ . ____ .2023

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

OBJEKTI I PROCEDURËS:

Sherbimi i pastrimit zona "Perendimore Marreveshje Kuader - me nje operator ekonomik ku te gjitha kushtet jane te percaktuara - me afat 36 muaj

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

Kodi CPV: 90522400-6 - Pastrimi dhe trajtimi i okës

VLERA E FONDIT LIMIT:

97,260,885(Nentedhete e shtatemilion e dyqind e gjashtedhjetemije e teteqind e tetedhete e pese) leke pa tvsh ose **869,254**(Teteqind e gjashtedhete e nentemije e dyqind e pesedhete e kater) Euro. Kursi i kembimit **111.89** LEK/EUR

Burimi i financimit: Buxheti i Bashkise viti 2023 i miratuar me VKB Nr. 71 date 27.12.2022 “Per miratimin e Buxhetit te vitit 2023 dhe programit buxhetor Afatmesem perfundimtar 2023 - 2025 te Bashkise se Shkodres”.

Procedura e prokurimit do te jete e llojit **Marreveshje Kuadër - me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 36(Tridhjetë e gjashtë) muaj** mbeshtetur ne nenin 52 te ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” dhe sipas nenin 60, pika 1/ç, nenit 61 pika 1, neni 62, neni 63, neni 64 pika 1/a , neni 65, neni 66 të kreu VII, e VKM nr. 285, dt. 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik, Udhezimit nr.6 date 16.01.2018“Per perdorimin e marreveshjes kuader dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike“ e ndryshuar. Arsyeya e perdorimit te Marreveshjes Kuadër - me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara eshte pasi Autoriteti Kontraktor ka nevoje per sherbime te nje natyre te perseritur ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara (objekti, sasitë, specifikimet) duke qënë se ky sherbim është një sherbim me natyrë të përsëritur vit pas viti dhe per te realizuar sherbimin e pastrimit pa nderprerje, duke eliminuar shtesa dhe amendamente te fillim vitit. Marrëveshja kuadër do të

aplikohet me një operator të vetëm ekonomik, me qëllim lidhjen e kontratave të bazuara në këtë marrëveshje, brenda kufijve dhe kushteve të parashtruara në marrëveshjen kuadër. Lidhja e marrëveshjes kuadër me një operator ekonomik është më e përshtatshme duke patur parasysh natyrën e shërbimit të pastrimit që është një shërbim ditor dhe i vazhdueshëm me natyrë të perseritur. Gjithashtu specifikimet teknike dhe termat e referencës të vendosura në kërkesat e Autoritetit Kontraktor, janë të përcaktuara, nga ana teknike dhe organizative.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **Bashkia Shkoder** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës ...;

b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit, sipas shtojcës...

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen me Nenin 76 “Kriteret detyruese për skualifikim” Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertes”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në mbështetje të Nenit 26 “Formulari përmbledhës i vetdeklarimit” dhe nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik:

Neni 82, i LPP “1. *Bashke me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si prova paraprake në vend të disa vertetimeve të leshuara nga autoritetet publike ose pale të treta, formularin përmbledhës të vetdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”.*

Neni 83 i LPP “*Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”.*

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik sipas Shtojcës 9.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 41, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik",

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2020-2021-2022, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40 % e vlerës së përlogaritur të kontratës, që prokurohet dhe konkretisht **38,904,354** (Tridhjetë e tetemilion e nenteqind e katermije e treqind e pesedhjetë e kater) Leke. *Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare..*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 2/a të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" *"Ne lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetit ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë që operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën", "Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.",* si dhe bazuar në nenin 43, pika 2/a të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" *Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: a) dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar".*

Vendosja e këtij kriteri kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik i zoteron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën.

Duke marrë në konsideratë numrin e operatorëve ekonomikë që ofrojnë këto lloje shërbimesh, sasinë dhe cilësinë e shërbimit objekt procedure prokurimi, afatin e kontratës dhe eksperiencat e mëparshme nga AK Bashkia Shkoder dhe Autoritete të tjera kontraktore kërkohet që OE ofertues të paraqesë se disponon kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare për ta realizuar atë në kohe dhe në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara. Për këtë, OE ofertues duhet të ketë

disponibilitetin e duhur ekonomik dhe me këtë qëllim, është argumentuar se vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se **38,904,354** (Tridhjetë e tetemilion e nentëqind e katermijë e treqind e pesëdhjetë e kater) Leke që është sa 40% e vlerës së fondit limit dhe vendosja e këtij limiti nuk kufizon pjesëmarrjen e operatoreve ekonomike pasi duke parë edhe eksperiencat e mëparshme ata mund të ofertojnë si bashkim operatorësh.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë në zbatim të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr.5, datë 30.01.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, VKM-së Nr. 922 datë 29.12.2014 “Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike”, si dhe kërkesave të Ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

AK në miratimin e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore”: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.”

2.2.2. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2020, 2021 dhe 2022, të certifikuara nga autoritetet përkatëse (Dega e Tatim Taksave) ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Referuar në nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e publikimit të njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 40 % të vlerës së përlllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe konkretisht **38,904,354** (Tridhjetë e tetemilion e nentëqind e katërmijë e treqind e pesëdhjetë e kater) Leke

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) Për përvojën e mëparshme të realizuar me ente publike, Operatori ekonomik duhet të paraqesë Kontratën e nënshkruar me entin, të shoqëruar me: a) faturat tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara dhe kur në faturat tatimore nuk përfshihen të gjitha zërat e shërbimeve, ato duhet të shoqërohen me situacionet ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara; b) vërtetimin e lëshuar nga Enti Publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera dhe afati i përfundimit të kontratës
- b) Për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

***Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 "Kërkesat për kualifikim", të Ligjit Nr 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" pika 4. "ne lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zoterojnë burimet e nevojshme njerezore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të pershtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në vecanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të pershtatshme nga kontrata e zbatuara në të shkuarën" dhe nenit 41, pika 3, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik". Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.*

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme

të jenë në vlerën maksimale 40% të vlerës së fondit limit, që është vlera kufi maksimale e përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Vlera e parashikuar e kontratës, është mbi kufirin e lartë monetar, vlera për shërbime të ngjashme prej **38,904,354** (Tridhjetë e tetemilion e nentëqind e katërmijë e treqind e pesëdhjetë e kater) Leke përbën nivelin maksimal prej 40% të përvojës së mëparshme që lejon LPP, duke patur parasysh objektin dhe vlerën e kontratës dhe në këtë mënyrë, AK ka sigurinë dhe besueshmërinë që OE ofertues mund të realizojë kontratën objekt prokurimi pa patur pengesa të ndryshme që do të ndikonin në ecurinë e punës së AK. Vlera prej 40% nuk kufizon aspak konkurrencën dhe është vendosur duke patur parasysh eksperiencat e mëparshme të AK.

Përvoja e mëparshme është një element shumë i domosdoshëm që garanton autoritetin kontraktor se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së kontratave të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie. Vlera e kërkuar nuk sjell kufizim të konkurrencës dhe është në masën 40% të fondit limit.

2.3.2. Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencë të vlefshme të shoqërisë e lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit , QKB për grumbullim dhe transportim të mbetjeve urbane (kodi III.2.B)

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme **2.3.3** është përcaktuar bazuar në pikën 2, të nenit 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, ”Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistroheshin në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë” dhe nenin 41, pika 4, gërma a,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ligjit nr.10081, datë 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, VKM Nr. 538, datë 26.05.2009, “Për Licencat dhe Lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta” e ndryshuar, Ligjin Nr. 10 463, datë 22.9.2011, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, i ndryshuar, Ligji nr. 10 431, datë 9.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit” Ligjin Nr 10448, datë 14.07.2011, “Për Lejet e Mjedisit”, pasi licenca me (kodi III.2.B) është në përputhje me zërat e preventivit të realizimit të shërbimit dhe specifikimet teknike ku kërkohet pastrimi, grumbullimi dhe transporti i mbetjeve urbane

2.3.3. Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë Çertifikatë ISO 9001:2015 *Sistemet e Menaxhimit të Cilësisë* (e vlefshme) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtare Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO.

2.3.4. Operatori ekonomik pjesmarrës duhet të paraqesë Çertifikatë ISO 14001-2015 *Sistemet e Menaxhimit Mjedisor* (e vlefshme) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme **2.3.3** e **2.3.4** është përcaktuar bazuar në nenin 79, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, “Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.” dhe pika 1, neni 44, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit.

Për vete natyrën e veçantë, vendndodhjes dhe përmasat e objektit të kontratës që do të prokurohet, është tepër e rëndësishme që operatorët të kryejnë shërbimet dhe realizojnë objektin e kontratës me standardet e kërkuara të cilësisë. Sistemi i menaxhimit të cilësië dhe të mjedisit janë standarde që çdo subjekt juridik apo privat e ka qëllim në arritjen e suksesit. Këto certifikata lidhen ngushtësisht me objektin e kontratës përse kohë do të pranohen edhe ekuivalentet e tyre dhe i shërbejnë autoritetit pergjegjes për njohjen e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen e plotë të kontratës.

Kriteri I mesiperm per paraqitjen e certifikatave ISO është në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese për operatorët.

2.3.5. Operatori ekonomik duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë (nga Administratori i shoqërisë) Drejtuesin Teknik të shërbimit të pastrimit për **Zonën Perendimore**, shoqeruar me dokumentacionin e mëposhtme:

- a) Diplomë
- b) CV përkatëse
- c) Kontrate pune midis tij dhe operatorit ekonomik (e vlefshme).

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 9 të DT.Dokumenti i kërkuar më sipër do të paraqitet përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në piken pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” *Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës*” dhe nenit 41, pika 4/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Drejtuuesi Teknik i shërbimit të pastrimit është përgjegjës për zbatimin e këtij shërbimi në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë brenda kushteve të kontratës. Duke ju referuar zerave të preventivit dhe specifikimeve teknike të tij, është shumë e rëndësishme për AK kapaciteti dhe përvoja e mëparshme në punë e drejtuesit teknik të këtij shërbimi që vertetohen në CV perkatëse të tij.

Kriteri I mesiperm për eksperiencën e drejtuesit teknik është në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurrohet dhe jodiskriminuese për operatorët.

2.3.6. Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të ketë të punësuar staf teknik për të paktën 3(tre) muajt e fundit si me poshte:

- 1 (një) Inxhinier Mjedisi ose 1 (Ekspert në fushën e Mjedisit)

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin:

- Kontratë pune e vlefshme, diplomë, CV
- Listë pagesat e sigurimeve shoqërore dhe tatimit të ardhura nga punësimi të konfirmuara nga organet tatimore për të paktën 3(tre) muajt e fundit.

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 9 të DT.Dokumenti i kërkuar më sipër do të paraqitet përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme **2.3.7 pika 2** është përcaktuar bazuar në piken pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” *Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës*” dhe nenit 41, pika 4/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, Ligji nr. 10 431, date 9.6.2011” *Per mbrojtjen e mjedisit*”

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Kriteri për stafin drejtues teknik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës, projektin, relacionet dhe raportet teknike, specifikimet dhe zërat e shërbimit që do të realizohen dhe do të monitorohen në vazhdimësi nga ky lloj inxhinieri. Nevoja për inxhinierin mjedisi në objekt është e diktuar nga përvoja e mëparshme, legjislacioni për mjedisin rekomandimeve të APP dhe vendimeve të KPP në lidhje me këto kriter me arsyetimin për mos të ngushtuar konkurrencën. Është vendosur periudha prej 3 (tre) muajsh pasi konsiderohet e mjaftueshme që ofertuesi të vërtetojë që ka një vazhdimësi në aktivitetin e përditshëm dhe angazhimin e strukturës së stafit drejtues.

Mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast rezulton në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe me cilësi të dobët. Numri i stafit kryesor është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e shërbimit. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën.

2.3.7 Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të disponojë fuqi punëtore për realizimin e kontratës prej minimalisht **43 (Dyzet e tre) persona** për 3 (tre) muajt e fundit. Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin Listëpagesen e sigurimeve shoqërore dhe tatimit të ardhura nga punësimi të konfirmuar nga organet tatimore për 3 (tre) muajt e fundit. *Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 9 të DT. Dokumenti i kërkuar më sipër do të paraqitet përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatëve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor aktor*

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Numri i punonjësve është përcaktuar bazuar në grafikun dhe orët e punës që duhen për të përmbushur zbatimin e kontratës. Numri i punonjësve dhe qëndrueshmëria e tyre në punë tregojnë besueshmëri për autoritetin. Dëshmia e kërkuar për numrin e fuqisë totale punëtore të operatorit ekonomik e nevojshme për ekzekutimin e objektit të kontratës, është dokument që vërteton kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, përsa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë çdo dëshmi me këtë

kohështrirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve dhe përvojën e tyre, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Punësimi i një numri të caktuar, si një nga kërkesat themelore të kualifikimit, përveç besueshmërisë së operatorëve ekonomik, është një tregues i kualifikimit dhe eksperiencës që duhet të ketë kjo kategori e punonjësve. Vendosja e kriterit për një punësim të paktën **43(Dyzet e tre) persona** është në përputhje me volumin e punës, natyrën dhe terrenin ku do të kryhen shërbimeve si dhe VKM për kohën e punës në muaj për punonjës. Po t'i referohemi preventivit, VKM, relacionit, matjeve përkatëse që janë bërë i është plotësisht i justifikuar numri i punonjësve. Kriteri për kualifikim është vendosur që t'i shërbejë autoritetit për të njohur gjendjen e kapaciteteve të operatorëve të cilët nëpërmjet dokumentacionit të vërtetojnë se zotërojnë, kapacitetet teknike dhe profesionale, personelin e nevojshëm, si dhe kapacitetet organizative, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Eshtë vendosur që numri i punonjësve në dispozicion të operatorit ekonomik për realizimin e kontratës të jete minimalisht **43(Dyzet e tre) persona** për 3(tre) muajt e fundit pasi kjo kërkesë lidhet me domodoshmërinë për realizimin e objektit të prokurimit, është në një numër të justifikuar dhe për një periudhë kohore të mëparshme prej 3(tre) muajsh por që i shërben vetëm objektit konkret.

Numri i përcaktuar i punonjësve është përlllogaritur si më poshtë:

Nr	Specialiteti	Njesi	Sasi
A	Puntore efektiv per gjithe vitin (zona 1)	persona	13
1	Shofere	persona	2
2	Puntor per mjetin teknologjik	persona	4
3	Drejtues teknik i kontratës	persona	1
4	Specialist , monitorues terreni	Persona	1
5	Punëtorë të përfshirë në pastrimin e plazhit/rërës (para hapjes të sezonit turistik dhe mbas përfundimit të sezonit)	Persona	5
B	Puntorë sezonal (110 ditë të sezonit turistik)	Persona	30
1	Specialist , monitorues terreni	Persona	1
2	Shofere	Persona	2
3	Puntor makine per grumbullim mbeturina sezonal	persona	4

4	Puntore per fshirje	persona	2
5	Puntore per mirembajtje ne zonen e reres (plazh Velipojë & Baks Rrjoll).	persona	4+1 rezerve
6	Punëtorë për mirmbajtjen e PGM've	persona	5+1 rezerve
7	Punetore per mirmbajtjen e kater tualeteve publike	persona	8+2 rezerve

1. Personeli i nevojshëm për grumbullimin dhe transportin e mbeturinave është një shofer dhe dy puntorë për çdo makinë që grumbullon dhe transporton mbetjet. Meqenese per NJ. Administrative duhen 2 mjete, atehere personeli i nevojshem eshte 2 shofere dhe 4 punetore gjate gjithë vitit. Ne periudhen e sezonit turistik nevojiten gjithashtu 2 mjete, dhe personeli i shtuar sezonal do jete 2 shofere dhe 4 punetore.
2. Kostot e puntorisë për zërin e preventivit “grumbullimi dhe transporti i mbetjeve urbane” është përlllogaritur sipas modelit të përlllogaritjes të kosos në zbatim të VKM nr.319 date 31.05.2018. Sipas kësaj përlllogaritje është shfaqur nëvoja për këtë nr.punëtorie bazuar në tonazhin e mbetjeve për nja'të, mjeteve në dispozicion për grumbullimin dhe transportin e mbetjeve.
3. Zëri punëtorë të përfshirë në pastrimin e plazhit/rërës (para hapjes të sezonit turistik dhe mbas përfundimit të sezonit) i bazohet Analizës An-2. Eksperienca e mëparshme me parapërgatitjet për hapjen e sezonit turistik në plazh Velipojë dhe mbylljen gjatë muajit shtator, ka shfaqur problematika në ndotjen e këtij territori nga prurjet e detit me shirat e dimrit & pranverës paras ezonit, me nisjen apo mbylljen e punës të njëjseve tregëtare, me pastrimin e stacioneve të plazhit, njëjseve akomoduese etj. Për këtë u vendos që të shtohen punëtorë në 21 ditë pune në total para/pas sezonit turistik, për ta mbajtur territorin e pastër në zonën e plazhit të Velipojës. Grafiku do të dorëzohet në formë shkresore nga ana e AK për operatorin sipërmarrës të shërbimit dhe do monitorohet në vazhdim sipas procedurës standarte dhe kontratës. Analiza An-1 paraqet përlllogaritjen e kosos të këtij shërbimi.Këtu numëri I punëtorisë është llogaritur për 21 ditë dhe për 168 orë e pune të shpërndarë në të gjithë brezine rërës të plazhit të velipojës. Duhen 5 punëtorë për plazhin e velipojs 7 km së bashku me baks rrjoll. Punëtorët do të jenë të angazhuar vetëm ditët javore të punës dhe vetëm në tetë orarin e punës. Ditët e punës në ëeekend do të zëvendësohen me ditët e javës sipas një grafiku përcaktuar nga Dr.e shërbimeve dhe miratuar nga AK. Punëtorët do të përfshihen edhe në mbledhjen e papastërtive që rëndomtë hidhen nga mjetet e turistevë nëpër rrugën nacionale të Velipojës.
4. Për fshirje manuale janë kërkuar dy punëtorë, kosto e llogaritur sipas Analizës sipas An-3;
5. Puntorë per mirembajtje të PGM-ve janë kërkuar gjashte punëtorë, nga keto pese duhet te jene te perhershem nje rezerve per te zevendesim kur eshte e nevojshme. Numëri i pikave të

grumbullimit në velipojë me sistemin e ri të mbledhjes të mbeturinave është ulur me 80 PGM. Numëri në total I PGM është 80 dhe në një distancë në total 20 km. Problematika e hasur gjatë gjithë sezonit turistik dhe jo vetëm edhe për gjatë gjithë vitit është mungesa e pastërtisë në pikat e grumbullimit për shumë faktorë. Mos respektimi i orareve të dorëzimit të mbetjeve, dorëzimi me karroca i mbetjeve në pikat e grumbullimit duke i hedhur përqark pikave të grumbullimit, kafshët e ndryshme si kuaj lopë dhe qen që kanë akses me pikat e grumbullimit etj, bëjnë që pikat të jenë problematike me mbetje përreth edhe kur kontenierët janë evaduar. Është menduar që me caktimin e orarit nga ana e AK për qytetarët dhe banorët e përhershëm të këtij territori cdo 16 pika grumbullimi të kenë një mirëmbajtës ku do të përgjigjet në cdo kohë sipas orarit të përcaktuar mbi mirëmbajtjen e pikës në të gjitha elementët e saj. Pika duhe të jetë e pastër në cdo kohë dhe në raste kur rezulton e pa pastër për cdo arsye do të ndërmerren penaltete. Bashkia Shkodër përgatit një grafik pune për mirëmbajtësit duke i caktuar pikat cdo mirëmbajtësi, mundësisht pranë nj-tj dhe oraret e punës sipas Analizës An4. Fondi I pagave eshte perllogaritur per pese punetore dhe nje puntor rezerv i cili do te duhet te angazhohet ne raste nevojje te AK nga operatori sipermarres, ne total 6 punetore. Në analizën e kostos janë përlogaritur ditët e festive dhe fundjavës, në zbatim të kuadrit ligjor përkatës cdo punëtori i është llogaritur paga me 126 ditë pune. Staf i mësipërm do të punësohet nga Kontraktori. Kushtet e punës për të gjithë stafin duhet të jenë në përputhje me legjislacionin në fuqi. Kështu stafi duhet të jetë i paisur me rrobat e përshtatshme të punës, me shenja dalluese që do të bëjnë të mundur identifikimin e tyre dhe gjatë natës, me doreza dhe paisje të tjera mbrojtëse. Listat e punonjesve duhet ti paraqiten Autoritetit Kontraktual me kërkesën e AK.

6. Gjithashtu për sa i përket zonës të rërës janë caktuar kater punëtorë ne total per gjithe zonen e reres dhe nje reserve per nevoja te Ak, per tu angazhuar nga operatori sipermarres . Nga keto për baks-rrjollin dy punetore duhet te jene stacionar në Baks-Rrjoll dhe dy punëtorë për te gjithe territorin e reres ne plazhin e velipojes. Meqënëse pastrimi i parcelave të plazheve private do të jetë një përgjegjësi e subjektit privat që e menaxhon plazhet private, pastrimi dhe mirëmbajtja e rërës (për hapësirat publike) në plazhin e Velipojës dhe të Baks – Rjollit do të kryhet me puntorë sezonal. Këta puntorë do të realizojnë grumbullimin e mbeturinave, që mund të jenë të përhapura nëpër rërë, me qese plastike. Meqënëse raporti i plazheve publike dhe private është përcaktuar 80% plazhe private dhe 20% plazhe publike atëherë vetëm 4(kater) punëtorë mundet të realizojnë pastrimin e plazheve publike dhe nje punetor do te duhet te jete rezerv kur te jete e nevojshme te angazhohet nga kontraktuesi, ne total pese punetore per pastrimin e zones te reres gjate sezonit veror. Grafiku i punës do të realizohet nga ana e autoritetit kontraktor dhe operatori do të jetë i detyruar të dorëzojë në fund të sezonit turistik listën e punëtorëve të punësuar dhe që i është realizuar pagesa e sigurimeve shoqërore. Analiza për këtë zë është llogaritur sipas An- 5.Kostot administrative kanë të përcaktuar shpenzimin administrative të kontratës , kosto e cila është përlogaritur në analizën e përgjithshme të kostos.

6.3.8 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të paraqesë një deklaratë me shkrim mbi disponueshmërinë e mjeteve, **ku të përcaktohet tipi(emertimi teknik),lloji,marka,nr. i shasisë,viti i prodhimit dhe sasi të përkatëse për mjetet si me mëposhte:**

- a) Makinë teknologjike transportuese, me ngarkim fundor ose anësor, me kapacitet mbajtës jo me pak se 10 ton, jo më pak se **5 (pese) copë**.
- b) Kamioncin deri ne 5 ton, veteshkarkues me sponda te adoptuara per sherbimin dere ne dere dhe per levizje kontanieresh jo më pak se **1 (nje) copë**;
- c) Makina teknologjike për fshirjen e rrugëve, jo më pak se **1 (një) copë**;
- d) Makina për larjen e rrugëve/pedonale, me kapacitet mbajtes jo më pak se 8-10 m3, jo më pak se **1 (një) copë**;
- e) Mjete teknologjike pastrimi rezerve jo me pak se 10 ton jo më pak se **1 (një) copë**.

Për Mjetet teknologjike të kërkuara në pikën **2.3.8**, gërma a – e, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin si më poshtë:

- Për mjetet e deklaruara në pronësi qe shënohen në regjistra publike duhet të paraqitet dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (akti i pronësisë) ,leje qarkullimi , çertifikate e kontrollit teknik, siguracion mjeti.
- Per mjetet e deklaruara me qera qe shënohen në regjistra publike duhet të shoqërohen me kontratën përkatëse noteriale te qirasë, dokumentin që verteton regjistrimin e mjetit (akti i pronësisë) , leje qarkullimi , çertifikate e kontrollit teknik, siguracion mjeti.
- Kontrata e qerasë duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës, objekt i këtij prokurimi
- Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publikë, të cilat deklarohen në pronësi, operatori ekonomik, duhet të paraqese kontraten e shitblerjes/fatura tatimore e shitjes si dhe dokumenti me të dhënat teknike të pajisjes ndërsa kur janë të marra me qera duhet të paraqitet kontrata e qerasë, fatura tatimore e shitjes/ kontrata e shitblerjes si dhe dokumenti me të dhënat teknike të pajisjes.
- Mjetet e porositura duhet të shoqërohen me Akt Marrëveshjen e porosisë/Kontratën e Porosisë (origjinal ose kopje e noterizuar). Akt Marrëveshja e porosisë/Kontrata e Porosisë duhet të përmbajë të dhënat e sakta në lidhje me **tipin e mjetit te porositur(emertimin teknik),llojin,marken,nr. e shasisë,vitin e prodhimit, kushtet e kontratës si dhe afatin për ekzekutimin e porosisë**. Akt Marrëveshja e porosisë/Kontrata e Porosisë duhet të shoqërohet dhe me katalogun e mjetit të porositur.
- Per mjetet e paregjistruara ne Republikën e Shqiperise, paraqitet marreveshje paraprake e shitblerje **sipas njerit prej rasteve ne vijim**,
(i) me pronarin e automjeteve.

(ii) me koncesionarin ose ndermjetesin ne rastin kur ka periudhe tranzitore per te pasur te drejten e posedimit te mjeteve.

(iii) me prodhuesin ose koncesionarin ne rastin e paraqitjes ne proceduren e prokurimit me mjete te reja.

Ne te gjitha rastet subjekti duhet te paraqese dokumentacionin e nevojshem i cili verteton se subjekti qe merr persiper furnizimin e mjeteve ka sipas dokumentacionit te vendit te origjines, te drejten per te pasur ne pronesi ose gezuar te drejten e shitblerjes se mjeteve te paraqitura.

- Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar në pronësi ose me qira ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit.

Kriteri konsiderohet i permbushur me plotesimin e formularit sipas shtojcës 9 të DT. Dokumenti i kërkuar më sipër do të paraqitet përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë mjetet dhe pajisjet që disponojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Numri dhe lloji i makinerive dhe paisjeve është vendosur duke ju referuar zerave te sherbimit sipas specifikimeve teknike, sipas grafikut te detajuar dhe kohëzgjatjes së sherbimit, Për të zbatuar kontratën, operatorët ekonomik duhet të përmbushin kapacitetet teknike të pajisjeve dhe aseteve të tjera fizike, për këtë janë përcaktuar edhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët. Nëpërmjet kapaciteteve teknike operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë aftësinë dhe kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative. Pajisje dhe mjetet e mësipërme janë të lidhura ngushtë me objektin e kontratës dhe i shërbejnë autoritetit pergjegjes për njohjen e kapaciteteve dhe të mundësisë së operatorit për përmbushjen me sukses të kontratës si dëshmi për mjetet dhe pajisjet sipas specifikave. Numri i mjeteve/makinerive që nevojiten për realizimin e kontratës është përcaktuar bazuar në zerat e sherbimit.

Nga ana e autoritetit kontraktor vendosja e këtij kriteri është në përpjetsitm më natyrën, zërat e punimeve dhe vlerën e kontratës si dhe përcaktimeve ligjore ne Kodin Civil..

a. Makinë teknologjike transportuese, me ngarkim fundor ose anësor, me kapacitet mbajtës 10-11ton (por jo me shume se 11 ton, per arsye se mjeti do te kaloje edhe ne terren te veshtire, ndaj

madhesia dhe pesha e mjetit duhet te jene sa me e ulet per kryer ne menyre eficente rrugetimin) , raport kompaktimi 1:4 - 1:6, jo me I vjeter se viti 2008 , **3 (tre) copë;**

Dy janë për NjA gjatë gjithë vitit, dhe një është për sezonin turistik në plazh Velipojë.

Mjetet teknologjike duhet të plotësojnë normat e lejuara të shkarkimeve në ajër të ndotësve të gaztë dhe të lëndës së ngurtë pezull, të përcaktuara. **Në zbatim të VKM 633 datë 26.10.2018 “Për masat kundër ndotjes së ajrit nga shkarkimet e mjeteve motorike dhe reduktimin e shkarkimeve në ajër të ndotësve të gaztë dhe të lëndës së ngurtë pezull nga motorët me ndezje pozitive dhe ata me ndezje me kompresion që djegin gaz natyror apo të lëngshëm për përdorim në automjete”,** i ndryshuar, sipas nenit 8 pika b dhe ç, duhet të jenë jo më të vjetër se viti 2008 dhe minimalisht të jenë Euro 3.

✓ Mjeti teknologjik pastrimi 10-11 ton për grumbullimin e mbetjeve në Njësitë administrative (Zona1), grumbullon mbeturinat me frekuencën dy herë në javë. Sasia e mbeturinave totale qe grumbullohen për një frekuencë është **29.6 ton** ose gjithsej 59.3 ton në javë. Jane kerkuar 2 mjete te cilet punojne me nga dy frekuenca në javë për të evaduar të gjithë sasinë e mbetjeve javore.

Sipas modelit “Per miratimin e masave per kostot e menaxhimit te integruar te mbetjeve” miratuar me VKM nr.319 date 31.05.2018, ne zone nevojiten 2 mjete me kapacitet 10-11 ton (85% faktor mbushje). Secili mjet grumbullon mesatarisht 7.4 ton per cdo rruge, prandaj për realizimin e plote te shërbimit duhet te realizohen 8 rrugë ne jave me dy mjete teknologjike (secili mjet ben nga 4 rruge te shperndara ne dite te ndryshme).

✓ Mjet teknologjik 10-11 ton për grumbullimin e mbetjeve të tërhequr nga kontenierët në zonën e plazhit gjatë sezonit turistik prej 110 ditësh, me frekuence nje here ne dite apo 7 here ne jave;

Sasia e mbetjeve totale qe grumbullohet per nje frekuence eshte 8.5 ton. **Sipas modelit “ Per miratimin e masave per kostot e menaxhimit te integruar te mbetjeve “ miratuar me VKM nr.319 date 31.05.2018, nevojitet 1 mjet me kapacitet 10-11 ton (85% faktor mbushje).**

b.Makinë teknologjike transportuese, me ngarkim fundor ose anësor, me kapacitet mbajtës 5-6 ton’ raport kompaktimi 1:4 - 1:6, viti i prodhimit jo me I vjeter se viti 2008 , 1 (një) cope. Mjeti teknologjik 5-6 ton, është kerkuar per grumbullimin e mbeturinave ne zonën Plazh Velipojë me skenarin e mbledhjes derë më derë për 110 ditë të sezonit turistik. Ne kete zone gjenerohen rreth 8.4 ton mbetje ne dite, te cilat do te mblidhen me mjetin teknologjik (eshte perzgjedhur nje tonazh i ulet i mjetit pasi do kaloje ne rrugica te ngushta). **Sipas modelit “ Per miratimin e masave per kostot e menaxhimit te integruar te mbetjeve “ miratuar me VKM nr.319 date 31.05.2018, nevojitet 1 mjet me kapacitet 5 ton (85% faktor mbushje)** qe do punoje me dy turne (rruge) per te realizuar plotesisht shërbimin (do grumbulloje mesatarisht 4.2 ton mbetje per secilen rruge. Mjetet teknologjike 5-6 ton, duhet të plotësojnë normat e lejuara të shkarkimeve në ajër të ndotësve të gaztë dhe të lëndës së ngurtë pezull, të përcaktuara. **Në zbatim të VKM 633 datë 26.10.2018 “Për masat kundër ndotjes së ajrit nga shkarkimet e mjeteve motorike dhe reduktimin e shkarkimeve në ajër të ndotësve të gaztë dhe të lëndës së ngurtë pezull nga motorët me ndezje pozitive dhe ata me ndezje me kompresion që djegin gaz natyror apo të lëngshëm për**

përdorim në automjete”, i ndryshuar sipas nenit 8 pika b dhe ç, duhet të jenë jo më të vjetër se viti 2008 dhe minimalisht të jenë Euro 3.

Ne llogaritjen e kostove operative (per mjetet) merret ne konsiderate kostoja e mirembajtjes se tyre. (siguracion, taksa, vaj, filtra, goma, mirembajtje mekanike, parking);

Kostoja e amortizimit per llogaritje per mjetet e perdorura eshte marre 15 % ne vit;

c-Mjet teknologjik pastrimi reserve 5 -6ose 10-11 ton.Ky mjet nevojitet per zevendesim ne rast se eshte me defekt ndonje mjet.

Shënim: Autoretiti /enti kontraktor mund të kërkojë edhe:

2.3 Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për shërbimet objekt prokurimi, që do të përfshihen në termat e referencës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 41, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Specifikimet teknike janë vendosur nga bashkepunimi me organizaten zvicerane DLDP si dhe tek VKB nr. 83, dt. 26.12.2017 “Për miratimin e planit lokal të menaxhimit të integruar të mbetjeve të ngurta urbane Bashkia Shkodër 2017 - 2022”